



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 8. prot

Tepelenë, më 31. 07.2025

PROCES-VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 31.07.2025, ora 10:15 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

- Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 26.06.2025.
- **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Qershor 2025”.
- **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor 2025”.
- **Projektvendim:** “Për detajimin e objektit Blerje mjete transporti për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike”, të parashikuar në zërin e shpenzimeve kapitale të buxhetit të vitit 2025.”
- **Projektvendim:** “Për miratimin e projekt dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 (faza e dytë).
- **Projektvendim:** “Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr. 124 ZK 3177, ndodhur në fshatin Rexhin Bashkia Tepelenë.”
- **Projektvendim:** “Për miratimin paraprak të planit të mbarështrimit të ekonomisë pyjore Kurvelesh pronë e Bashkisë Tepelenë.”
- **Projektvendim:** “Për miratim e objekteve prioritare, ndëtimi i info-point, vendparkimi dhe aksesit të rrugës në parkim.”

- Raportim nga drejtoria e Shërbimeve Publike “Mbi masat e mara për ruajtjen dhe zgjerimin e ambjenteve të gjelberuara në qytet si dhe grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane në përputhje me standartet e lejuara, masat që janë marë për sistemimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe atyre publike në Bashkinë Tepelenë”
- Informacion mbi rezultatet e Barometrit Gjinnor në Bashkinë Tepelenë në bazë të legjislacionit shqiptar mbi barazinë gjinore, realizuar nga Aleanca e Grave Këshilltareve Bashkiake dhe Komisioni i Barazisë Gjimore, me mbështetjen teknike të programit Bashki të Forta.
- Çështje të tjera

Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes 10.15

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Arben Gumeni
- Latif Kacaj (largohet nga mbledhja ora 10.40, kthehet ora 10.45)
- Marsela Balili
- Matilda Çela (prezent në mbledhje ora 10.25)
- Ilir Haska
- Ditar Hodaj (prezent në mbledhje ora 10.40 larguar nga mbledhja ora 10.52)
- Miftar Meta
- Mirela Varfi
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë:

- Spiro Kora
- Gëzim Shehu
- Lumturi Dervishi
- Armand Sala
- Rovenë Mullaraj
- Festime Elezi
- Adi Velaj

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni:

Përsëritet të gjithëve. Mbledhjen e deklaroj të hapur. Fillojmë me rendit të ditës. A jeni dakord me rendin e ditës?

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Votimi: Vota PRO (8): Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj,

- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë.

Pika e dytë e rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 26.06.2025

Kryetari i Këshillit i drejtohet këshilltarëve nëse kanë komente apo vërejtje lidhur me përmbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes datë 26.06.2025.

Votimi: Votimi: Vota PRO (8): Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj, Esmeralda Bishani.

- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Pika 3 e rendit të ditës:

Projektvendim: Për miratimi i ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Qershor 2025

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e shqyrtimit të projektvendimit.

Z. Latif Kacaj, nënkryetar i Komisionit të Ekonomisë:

Komisioni i Ekonomisë, i mbledhur ditën e djeshme, vendosi që pika 3 e rendit të ditës t'i propozohet këshillit për miratim. Nuk ka ndryshime krahasuar me muajin e kaluar.

Kryetari i Këshillit: A ka ndonjë pyetje?jo.

hapja e votimit për miratimin e projektaktit.

Votimi: Vota PRO (8): Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj, Esmeralda Bishani.

- **Vota KUNDËR:** Asnjë

- **Abstenim:** Asnjë

Pika 4 e rendit të ditës:

Projektvendim: *Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Qershor*

Z. Latif Kacaj, nënkryetar i Komisionit të Ekonomisë:

Komisioni e ka shqyrtuar materialin dhe propozon miratimin e tij.

Kryetari i Këshillit: A ka ndonjë pyetje?jo

hapja e votimit për miratimin e projektaktit.

Votimi: Vota PRO (8): Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj, Esmeralda Bishani.

- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Pika 5 e rendit të ditës:

Projektvendim: *“Për detajimin e objektit 'Blerje mjete transporti' për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të parashikuara në zërin e shpenzimeve kapitale të buxhetit të vitit 2025”*

Z. Spiro Kora relaton materialin:

Në buxhetin e miratuar për vitin 2025 nga Këshilli Bashkiak, me vendimin nr. 72, datë 27.11.2024, është parashikuar objekti i shpenzimeve kapitale “Blerje mjete transporti për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike (DShP)”.

Për realizimin e këtij objekti dhe në funksion të përmirësimit të shërbimeve publike dhe ndërhyrjeve në territor, parashikohet blerja e mjeteve të mëposhtme:

Një kamionçinë vetëshkarkuese, me kapacitet deri në 4 ton, e pajisur me kabinë 4+1 vende. Mjeti do të përdoret për transport të inerteve, pajisjeve dhe për ndërhyrje të shpejta në rrugë dhe hapësira publike.

Një automjet tip fuoristradë “Pick-up”, me karroceri të hapur dhe 4+1 vende, i përshtatshëm për operacione në terrene të vështira, për transport veglash, punëtorësh dhe për ndërhyrje emergjente.

Ky detajim është një veprim teknik dhe buxhetor i domosdoshëm për përgatitjen e dokumentacionit të prokurimit dhe zhvillimin e procedurës sipas ligjit nr. 162/2020, Për prokurimin publik.

Kryetari i Këshillit: A ka ndonjë pyetje nga anëtarët? jo

Kryetari deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektaktit.

Votimi: Vota PRO (8): Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj, Esmeralda Bishani.

- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Pika 6 e rendit të ditës:

Projektvendim: *“Për miratimin e projekt-dokumentit të parë të Programimit Buxhetor Afatmesëm 2026–2028 – Faza e dytë”*

Z. Spiro Kora, Drejtor i Financës, relaton materialin:

Sot paraqitet për shqyrtim dokumenti i parë i PBA 2026–2028, i cili pason miratimin e parashikimeve afatmesme të ardhurave dhe tavnaneve përgatitore PBA2026-2028 të miratuara me vendimin e Këshillit Bashkiak të muajit Mars.

Një nga elementët kryesorë të këtij dokumenti është rënia e numrit të punësuarve në periudhën afatmesme, si rezultat i analizës së burimeve njerëzore dhe për shkak të fondeve të kufizuara të parashikuara për pagat dhe sigurimet shoqërore.

Megjithatë, numri i punonjësve për tre vitet e ardhshme mbetet i pandryshuar në funksionet bazë, duke garantuar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve publike. Numri i punonjësve me kontratë do të jetë 10.

Të ardhurat e veta mbeten nën 20% të totalit të buxhetit, çka nënvizon nevojën për forcimin e kapaciteteve vendore në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Treguesit e buxhetit reflektojnë një strukturë të qëndrueshme, megjithëse shpenzimet për administratën dhe pagat mbeten të larta. Tavani i shpenzimeve të miratuara në mars 2025 nuk ka ndryshime të theksuara.

Shpenzimet kapitale mbeten nën 11% të buxhetit, duke theksuar nevojën për rritjen e investimeve për zhvillimin.

Znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë:

Komisioni i Ekonomisë, i mbledhur më datë 30.07.2025, pasi shqyrtoi materialin, vendosi ta kalojë atë për miratim në Këshill. Ftoj anëtarët ta votojnë.

Kryetari i Këshillit: A ka pyetje?

Nuk ka pyetje.

hapja e votimit për miratimin e projektvendimit.

Votimi: Vota PRO (9): Arben Gumeni, Marsela Balili, Matilda Çela, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj

- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Projektvendimi miratohet me shumicë votash.

Pika 7 e rendit të ditës:

Projektvendim: “Për azhurnimin e hartës kadastrale për pasuritë nr. 124, ZK 3177, ndodhur në fshatin Rexhinë, Bashkia Tepelenë”

Z. Gëzim Shehu relatton materialin e bashkëlidhur:

Grupi i punës i ngritur pranë Bashkisë Tepelenë, me urdhrin nr. 76, datë 02.06.2025, ka shqyrtuar kërkesën për azhurnimin e të dhënave kadastrale për pasuritë e ndodhura në fshatin Rexhinë.

Ky azhurnim është i nevojshëm në kuadër të lirimit të sheshit të ndërtimit të objektit Përmirësim i transportit publik dhe për përditësimin teknik të regjistrave të pasurive në përputhje me planin zhvillimor të bashkisë, në funksion të projektit “Aksesit nëpërmjet ndërhyrjeve në rrugë të bardha – Faza II, **segmenti Nivicë–Lluftë**”, të kërkuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pas verifikimeve në terren nga grupi i punës, rezultoi se:

1. Rruga ekzistuese, e pasqyruar në hartën kadastrale, është e shkatërruar nga erozioni për rreth 30 vjet dhe është kthyer në përrua.
2. Rruga aktualisht e përdorur në terren kalon në pronë private të trajtuar sipas ligjit nr. 7501, çka e bën të pamundur lirin e sheshit të ndërtimit për këtë segment.
3. Si rrugë kalimi është përdorur pasuria nr. 124, e llojit tokë arë, në pronësi shtet dhe në inventarin e Bashkisë Tepelenë.

Pyetje;

- **Miftar Meta:** Rruga kalon pranë rezervuarit, segmenti do të spostohet jashtë rrugës së vjetër.
- **Gëzim Shehu:** Gjurmimi i ri kalon në territorin e fshatit Lluftë, jashtë pronave private, duke përdorur pasurinë shtetërore.

- **Vladimir Bakiaj:** Të vendoset një shenjë identifikuese në këtë pasuri, për t'u dalluar në terren.
- **Miftar Meta:** Në Nivicë ka shqetësime nga futja e automjeteve në sheshin qendror – sidomos për të moshuarit.
- **Arben Gumeni:** Duhet të bëhet një kërkesë/ankesë zyrtare në Bashki që të ndalohen automjetet në zonën e sheshit në Nivicë.

Kryetari i Këshillit: A ka pyetje? jo

hapja e votimit për miratimin e projektaktit.

Votimi: Vota PRO (9): Arben Gumeni, Marsela Balili, Matilda Çela, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Latif Kacaj.

- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Projektvendimi miratohet me shumicë votash.

Pika 8 e rendit të ditës:

Projektvendim: *“Për miratimin paraprak të planit të menaxhimit të ekonomisë pyjore të njësisë Kurvelesh, pronë e Bashkisë Tepelenë”*

Z. Gëzim Shehu relaton materialin, bazuar në relacionin teknik të përgatitur nga specialistët përkatës.

Kjo është ekonomia pyjore e parë që po hartohet për të gjithë sipërfaqen që Bashkia Tepelenë ka në inventar si pronë publike. Procesi ka nisur me zonën e Kurveleshit, për shkak të vlerave natyrore, turistike dhe mundësive financiare të bashkisë.

Është zhvilluar një takim me komunitetin dhe kryetarët e fshatrave për të mbledhur mendime dhe kërkesa që plani të hartohet në bashkëpunim me banorët.

Theksojmë se bëhet fjalë për një miratim paraprak – miratimin përfundimtar e jep Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

Kryetari i Këshillit: A ka pyetje?

Latif Kacaj largohet nga mbledhja në orën 10:38.

Hapet votimi për miratimin e projektaktit.

Votimi:

- **Vota PRO (8):** Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Matilda Çela
- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Ditar Hoda i bashkohet mbledhjes në orën 10:40.

Pika 9 e rendit të ditës:

Projektvendim: *“Për miratimin e objekteve prioritare: ndërtimi i info-point, vendparkimi dhe aksesit të rrugës në zonën e parkimit”*

Z. Spiro Kora relaton materialin:

Në kuadër të projektit të rrjetëzimit të Kalasë së Tepelenës, që po zbatohet nga Qeveria Shqiptare në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), parashikohet realizimi i disa ndërhyrjeve të rëndësishme në infrastrukturën e qytetit.

Projekti përfshin ndërtimin e:

- Info-point-it turistik,
- Një zone parkimi,
- Dhe aksesit rrugor deri në parkim.

Ky projekt është bashkëfinancim ndërmjet FSHZH-së, Qeverisë Shqiptare dhe Bashkisë Tepelenë.

Bashkia ka përmbushur fazën e parë të projektimit dhe zhvillimit të procedurës së prokurimit, ka lidhur kontratën me subjektin zhvillues dhe ka shpallur fituesin. Fituesi ka për detyrë hartimin, miratimin dhe zbatimin e projektit.

Faza e parë (projektimi) është përfunduar dhe projekti është dorëzuar pranë bashkisë.

Në zbatim të këtij procesi, Kryetarja në detyrë e Bashkisë Tepelenë ka nxjerrë Urdhrin nr. 84, datë 09.07.2025, për ngritjen e grupit të punës për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të projektit. Grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 84, datë 09.07.2025, përbëhet nga specialistë të fushës dhe drejtohet prej meje. Ky grup është mbledhur, ka shqyrtuar projektin dhe ka hartuar një raport teknik, i nënshkruar nga anëtarët e komisionit, i cili i bashkëlidhet këtij material.

Kërkojmë miratimin në parim të objektit dhe dhënien e autorizimit për fillimin e zbatimit të projektit.

Z. Gëzim Shehu: Projekti fillon tek info-pointi, në sheshin përballë Kishës në hyrje të rrugës, dhe vazhdon përgjatë rrugës ekzistuese, përballë godinës së ish-Prokurorisë, lidhet me pedonalen pranë bankës dhe përfundon në zonën pranë ish-hotel “Turizmit”.

Z. Vladimir Bakiaj: Cila është perspektiva e kësaj rruge që i shërben dhe projektit të Kalasë? Nuk e dime kapacitetin e parkingut, a e perballon fluksin e autobusëve, ne sot emergjence autobuzet e turistave nuk kane ku te futen, kanë vështirësi për të hyrë. Ky parking qe do ti shërbej kalasë, hyrja është e ngushtë dhe nuk ka hapësira për manovrim. Nuk është parashikuar zgjerim i rrugës, hyrja shume e dobet hynë në rrugën kryesore të qytetit. Te hyje autobuzi shume e vështire, nuk e di kapacitetin e parkingut Para disa vitesh është miratuar një vend për parking, do ishte më mirë që të ndërtohej një parkim për autobusët dhe qytetarët, sepse kjo hyrje nuk është e përshtatshme.

Z. Arben Gumeni: Kjo rrugë është e rëndësishme për banorët dhe për qytetarët e Tepelenës, por edhe për turistët. Jam dakord që duhet t'i kërkojmë bashkisë të parashikojë ndërtimin e parkingjeve. Rruga është e domosdoshme dhe duhet të realizohet. Megjithatë, sqaroj se kjo rrugë nuk është projektuar nga bashkia, por nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH).

Z. Vladimir Bakiaj: Mendoj se më mirë do ishte që këtë rrugë ta ndërtonte vetë bashkia, ndërsa fondi shqiptar të realizonte një projekt tjetër më të rëndësishëm për qytetin nje parking

Z. Arben: Është e domosdoshme të ndërhyhet. Nëse nuk ka më pyetje apo diskutime, të kalojmë në votim.

Z. Vladimir Bakiaj: Nënkyetar a ke ndonjë koment për mendimin tim, meqenëse bëhet fjalë për një projekt të Fondit të Zhvillimit?

Z. Ditar Hodaj: Jepi fjalën Ladit iu drejtua nënkryetarit për sqarim – i takon fjala.

Z. Arben Gumeni: Çfarë pyetje ka bërë konkretisht?

Z. Ditar Hodaj: Mbledhja është në orën 09:00 dhe 10:00. Unë jam në shërbim të qytetarëve.

Z. Arben Gumeni: Nuk na ke njoftuar për këtë.

Z. Ditar Hodaj: Ju kam informuar sekretaren dhe juve gjithashtu. Ju kërkon shërbim ndaj qytetarëve, ndërkohë që unë kam pasur çështje të rëndësishme për të diskutuar në mbledhje dhe më është hequr e drejta e fjalës ndoshta me qëllim.

Z. Arben Gumeni (Kryetar i Këshillit): Nuk mund të ndryshojmë orarin e mbledhjes për një anëtar të këshillit. Nëse shumica është e pranishme, mbledhja vazhdon normalisht.

Z. Ditar Hodaj: Jam i zgjedhur si ty. E kam thënë disa herë që kam angazhime. Këtu në mbledhje e kam përmendur disa herë, por ti thua një s'ka rëndësi, ndërkohë që bëni çmos të mos diskutoj unë.

Z. Arben Gumeni: Këtu nuk e ke përmendur qartë.

Z. Ditar Hodaj: E kam thënë edhe në këtë mbledhje. Ti vendos që do vazhdoni pa mua, dhe kjo bëhet qëllimisht për të më përjashtuar nga diskutimi.

(Z. Ditar Hodaj largohet nga mbledhja në orën 10:52.)

Z. Arben Gumeni: Secili duhet të bëjë detyrën që i takon. Për mbledhjet e Këshillit ka një rregullore Z. Ditar këtë shqetësim nuk e ka ngritur zyrtarisht gjatë mbledhjes, por vetëm në mënyrë private.

Znj. Matilda Çela: Kjo çështje duhet të trajtohet në një moment tjetër. Të vijojmë me diskutimin për pikën në fjalë.

Z. Arben Gumeni: Z. Vladimir Bakiaj ngriti shqetësimin për mungesën e parkingjeve. Duhet t'i kërkojmë bashkisë të paraqesë kërkesë pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit për ndërtimin e një parkimi publik.

Z. Vladimir Bakiaj: Është dashur që më parë të ishte planifikuar një hapësirë për parking. Pa të, hyrja për autobusët dhe qarkullimi janë të vështira.

Z. Spiro Kora: Sipas projektit aktual janë parashikuar vetëm 320 m² parkim, specifikisht për turistët dhe rrjetëzimin me projektin e Kalasë. Kemi kërkuar ndërtimin e një parkimi më të madh për qytetin, por ky projekt mbulon vetëm zonën e Kalasë.

Z. Vladimir Bakiaj: Jam dakord që rruga të realizohet për të zhvilluar turizmin, por parkimi për qytetarët duhet të mbetet prioritet.

Z. Spiro Kora: Parkimi i propozuar në këtë projekt është vetëm për turistët dhe është i lidhur me rrjetëzimin e kalasë. Kemi paraqitur kërkesa të tjera për parkim të përgjithshëm, jashtë këtij projekti.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, shpall hapjen e votimit për miratimin e projektaktit.

- **Votimi: Vota PRO 9:** Arben Gumeni, Marsela Balili, Mirela Varfi, Miftar Meta, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj, Matilda Çela, Latif Kacaj.
- **Vota KUNDËR:** Asnjë
- **Abstenim:** Asnjë

Pika 10: Raportim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike “Mbi masat e mara për ruajtjen dhe zgjerimin e ambjenteve të gjelberuara në qytet si dhe grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve urbane në përputhje me standartet e lejuara, masat që janë marë për sistemimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe atyre publike në Bashkinë Tepelenë”

Znj. Matilda Çela: E kemi lexuar materialin e raportit. Do të donim të bënim disa pyetje dhe sqarime për çështje specifike.

Z. Latif Kacaj: Në Njësinë Administrative Lopës jam i pakënaqur me shërbimet publike. Pastrimi i varrezave është në gjendje të keqe. Rruga që kalon pranë varrezave në fshatin Dashaj

është e paasfaltuar, mungojnë pusetat.

Çezmat publike të shtrohen me çimento në Lopës janë jashtë funksionit. Këto janë ndërtuar për komunitetin, por nuk shfrytëzohen. Duhet të kërkohet nga administratori dhe punonjësit ndërhyrje për mirëmbajtje.

Në Matohasanaj, çezma është problematike dhe kërkon ndërhyrje urgjente.

Po ashtu, duhet të ndërhyhet edhe në çezmën e fshatit Dhëmbel, e cila është jashtë funksionit.

Znj. Mirela Varfi: Në fshatin Dukaj nuk ka kontenierë për mbeturinat. Vetëm në qendër është vendosur një, ndërsa në lagjet e tjera mungojnë. Kjo e bën të pamundur menaxhimin e mbetjeve dhe paraqet problem për banorët.

Z. Miftar Meta: Kërkoj ndërhyrje të menjëhershme në varrezat e fshatit Kurvelesh për pastrim dhe mirëmbajtje.

Z. Vladimir Bakiaj: Drejtoria përkatëse duhet të marrë masa. Janë administratorët ata që duhet të raportojnë dhe të jenë të pranishëm në këto mbledhje për të dhënë sqarime.

Z. Adi Veliaj: Drejtor i Shërbimeve Publike:

Punonjësit e shërbimeve në njësitë Lopës dhe Kurvelesh janë nën menaxhimin e administratorëve. Për çështjet e ngritura u përgjigjemi mbi bazë të mundësive materiale dhe me specialistë (hidraulikë, elektrikistë).

Sa i përket pastrimit të rrugëve dhe varrezave, ne dërgojmë punonjësit në terren sipas planifikimeve dhe kërkesave.

Për kontenierët në Dukaj, shpërndarja është bërë sipas infrastrukturës së mundshme – jo çdo lagje ka akses rrugor. Banorët duhet të përdorin automjetet e tyre për të depozituar mbetjet në kontenierët e caktuar.

Znj. Matilda Çela: Në qytetin e Tepelenës, varrezat e vjetra janë në gjendje shumë të keqe. Muri rrethues është i mbuluar me mbeturina. Kërkoj të merren masa urgjente.

Kopshtet e kateve të para të pallateve janë zaptuar dhe e kam ngritur disa herë këtë shqetësim. Po uzurpohet hapësira publike dhe askush nuk vepron.

Gjithashtu, në rrugën pedonale nuk mund të realizohen shërbime apo pastrim sepse bizneset kanë zënë gjithë hapësirën. Ky është një problem që ka marrë zgjidhje në qytete të tjera përmes aksioneve, ndërsa në Tepelenë situata vazhdon.

Në të gjitha hapësirat ku ka zaptim që rrezikon jetën e qytetarëve duhet të ndërhyhet. Kemi ankesa të shumta nga qytetarët që nuk po trajtohen.

Z. Vladimir Bakiaj: Në hapësirat publike nuk duhet të vendosen objekte të tilla si kioska apo vazo lule në bankomate. Policia bashkiake duhet të ndërhyjë dhe të heqë çdo objekt që nuk ka autorizim.

Z. Adi Veliaj: Për murin e varrezave kemi filluar procesin e pastrimit. Sa i përket hapësirave publike, kemi marrë urdhër të posaçëm nga Kryetarja e Bashkisë për lirimin e tyre – si pedonalet, rrugët kryesore dhe çdo hapësirë e zaptuar në mënyrë të paligjshme.

Z. Arben Gumeni (Kryetar i Këshillit):

A ka ndonjë pyetje tjetër?

Informacion mbi Barometrin Gjinor

Znj. Mirela informoi se Komisioni i Barazisë Gjinore ka shqyrtuar rezultatet e zbatimit të detyrimeve ligjore për barazinë gjinore. Nga 24 detyrime të përcaktuara me ligj për pushtetin vendor, Bashkia Tepelenë ka përmbushur 13 prej tyre, të cilat janë të përfshira në raportin përkatës.

Çështje të tjera

Kërkesë për vazhdim kontrate z.Kastriot Mustafa Qeriza

Arben: Kemi një kërkesë nga Kastriot Mustafa Qeriza, i cili kërkon vazhdimin e kontratës me qira për 99 vjete të bërë në vitin 2011. Kontrata e tij i është ndërprerë për arsye të mos zbatimit të kontratës dhe ai kërkon vazhdimin e kontratës së qirasë që ka bërë me Bashkinë. Ai ka paguar të gjitha detyrimet për vitet përkatëse. Bashkia i ka dhënë këtë pronë me kontratë njëvjeçare një personi tjetër, ndërsa ai pretendon se është pronar i kesaj prone dhe kërkon të vazhdojë kontratën e qirasë, për shkak të pamundësisë për të marrë pronën. Ai kërkon që toka të mos i jepet askujt tjetër për të shmangur konfliktin. Ne nuk duam që të ketë përplasje, ndaj jemi pjesë e zgjidhjes dhe evitimit të konflikteve.

Z. Gezim Shehu: Drejtor i Zhvillimit Rural:

Gezim: Kontrata është lidhur në vitin 2011 nga ish-Komuna Qendër Tepelene. Nga kontrollet tona, dy herë në vit, për zbatimin e kontratave të qirasë që nga viti 2020, kemi kryer verifikime dhe ka kaluar periudhë e gjatë nga lidhja e kontratës deri në vitin 2024. Janë dy persona që nuk e kanë zbatuar kontratën në aspektin e mbjelljes. Kemi bërë njoftime për këta persona se kontrata do t'u zgjidhet, për shkak se nuk është mbjellë, pavarësisht pagesës, siç parashikon ligji. Zgjidhja e kontratës bëhet për moszbatim të kushteve, jo për mos pagesë. Janë prerë dy kontrata në fshatin Veliqot, njëra prej të cilave është edhe kjo. Njoftimi për zgjidhjen e kontratës është bërë në maj 2024, dhe nga ajo datë nuk ka ardhur asnjë pretendim apo kërkesë. Në nëntor 2024, kontrata është zgjidhur zyrtarisht. Më pas, në shkurt 2025, këta persona kanë kërkuar vazhdimin e kontratës.

Znj. Matilda: Duke qenë se ai ka paguar rregullisht detyrimet, megjithëse nuk e ka mbjellë, a ka mundësi që t'i jepet përsëri me qira për të shmangur konfliktin? Nëse i jepet dikujt tjetër, do të krijohen tensione dhe përplasje në komunitet. Në këto raste duhet të veprojmë me kujdes për të mos nxitur konfliktet.

Z. Gezim: Eshtë procedure konkurimi nuk ka pse të ketë konflikt

Znj. Matilda: Edhe për rastin e Ujit të Ftohtë kemi diskutuar raste të shkeljeve të kontratave. Si veprohet në këto raste?

Z. Gezim: Në rastin e Ujit të Ftohtë, palët në fjalë nuk kanë kontratë me Bashkinë.

Këshilltari Vladimir Bakiaj: Kur është mbyllur kontrata me këtë zotëri?

Z. Gezim: Kontrata është zgjidhur në vitin 2024.

V. Bakiaj: Ai ka bërë pagesa. Pse janë pranuar këto pagesa nëse ishte në shkelje?

Z. Gezim: Ka bërë pagesa, por kontrata është zgjidhur për shkak të mos zbatimit të detyrimeve për mbjelljen e tokës, jo për mospagim. Pagesat janë pranuar për periudhat përkatëse që ka përdorur tokën.

Këshilltari Latif Kacaj: Nëse kishte shkelje në kontratë, pse i janë marrë pagesat?

Znj. Matilda: Ai është i gatshëm të paguajë sërish. Nëse është në rregull, ta marrë tokën përsëri dhe ne të marrim një vendim në këtë drejtim.

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni: Gezim, deri sa të sqarohet kjo situatë, mos ia jepni askujt tjetër me qira. Nuk duhet të futim dy familje në konflikt. Na sillni të gjitha kontratat që janë dhënë me qira dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së tyre.

Z. Gezim: Disa kontrata nuk janë respektuar. Si drejtori nuk kemi dhënë kontrata të reja. Për këtë rast është bërë njoftimi dhe kemi disa kontrata të tjera që janë drejt zgjidhjes.

Z. Arben: Kjo tokë është dhënë me vendim të Këshillit Bashkiak. Para se të zgjidhet kontrata, duhet të vijë sërish në Këshill. Nuk mund të veprohet pa informuar këshillin, ne duhet të shmangim situatat që çojnë në konflikte.

Z. Gezim: Procedura e zgjidhjes është ligjore dhe e ndjekur sipas rregullave. Nuk është një vendim individual.

Z. Arben: Ti duhet të informoje administratorin që toka është e lirë dhe të na njoftoje si Këshill. Nuk mund të veprohet pa koordinim. Për më tepër, shumica e kontratave nuk janë zbatuar dhe 90% e tyre nuk kanë paguar detyrimet. Ju kemi kërkuar informacion për kontratat e qirasë, por nuk kemi marrë informacion.

Z. Gezim: Deri në sqarimin përfundimtar, toka nuk do të jepet me qira.

Znj. Matilda: Në momentin që ky person ka paraqitur kërkesë për të vazhduar kontratën, nuk kemi arsye ta refuzojmë nëse nuk ka kërkesa të tjera. Le ta marrë ai që e ka pasur, për të shmangur konflikte.

Z. Arben: Si mendoni?

Znj. Matilda: Mendoj që kontrata duhet t'i vazhdohet atij që e ka pasur.

Znj. Esmeralda Bishani: Edhe unë mendoj që të vazhdohet kontrata me të njëjtin person.

Kryetari i Këshillit: Matilda shprehu mendimin që kontrata e tokës me qira të vazhdojë me personin që e ka pasur më parë.

Vladimir Bakiaj: Ne nuk kemi faj për veprimet që janë kryer më parë. Nëse ne si Këshill vendosim për vazhdimin e kontratës me të njëjtin person, atëherë bashkia duhet të respektojë vendimin dhe të kthejë në fuqi kontratën.

Z. Arben Gumeni: E drejta për dhënien me qira të tokave është kompetencë e Këshillit Bashkiak. Nëse Këshilli e miraton, procedura mund të vazhdojë. Nëse nuk e miraton, Bashkia nuk ka të drejtë ta japë.

Këshilltari V. Bakiaj: Nëse vendosim që toka t'i jepet personit që e ka pasur më parë, automatikisht bashkia duhet të anulojë vendimin për zgjidhjen e kontratës së mëparshme.

Kryetari, z. Arben Gumeni: Ka ndonjë mendim tjetër përveç propozimit të znj. Matilda? Ta hedhim në votim propozimin që kontrata të vazhdohet me personin që e ka pasur më parë, duke i vendosur afat për zbatimin e saj.

Votimi: Pro: 8 vota pro.

1. **Kërkesa e znj. Vjollca Çela për rikostruksion banese.**

(bashkelidhur kerkesa)

Kryetari propozon që kjo kërkesë t'i delegohet Bashkisë për ndërhyrje pranë kësaj familjeje.

2. **Kërkesa e z. Mentor Kanani për ndihmë financiare për shpenzime shëndetësore.**
(bashkelidhur kerkesa)

Propozohet që kërkesa t'i delegohet Bashkisë për shqyrtim dhe mbështetje sipas mundësisë.

3. **Kërkesa e znj. Enkelejda Pushi për ndihmë financiare**

(bashkelidhur kerkesa)

Znj. Matilda; Znj Enkelejda ka dalë nga skema e ndihmës ekonomike e kemi diskutuar në komision në mbledhjet e kaluara.

Propozohet që kërkesa t'i delegohet Bashkisë për shqyrtim dhe mbështetje sipas mundësisë.

4. **Kërkesë për vlerësim dëmi nga zjarri**

Kryetari: Për këto raste ndjeket procedura përmes Emergjencave Civile dhe vlerësimit me dokumentacionin përkatës. Kërkuesi të drejtohet pranë Zyrës së Emergjencave të Bashkisë.

5. **Kërkesë për hapje rruge për të shkuar në shtëpi z. Imer Elezaj Njesia Administrative Lopës, fshati Lab Martalloz**
Kërkesa i kalon Bashkisë për verifikim nga zyra përkatëse.
6. **Kërkesë për zgjerimin e rrugës – z. Nuro Elezaj Njësia administrative Lopës (Bashkelidhur kerkesa)**
Kërkesa i delegohet Bashkisë, për shqyrtim nga zyra përkatëse.

Ju faleminderit!

Mbledhja u mbyll në orën **11:50**.

SEKRETAR KËSHILLI

Valbona ÇELA

KRYETAR KËSHILLI

ARBEN GUMENI

